

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 494 datë- 14.8.2001

PER

**ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT TE
PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001, "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave", të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 7, të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2001", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1 . Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike (IPIE) është person juridik buxhetor, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit i specializuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave, që garantojnë sigurinë e punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike, në veprimtarinë e personave juridikë dhe fizikë.
2. Inspektorati drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Kryeinspektori dhe inspektorët në qendër përbëjnë nivelin qendror të organizimit. Inspektorët e zonave, brenda juridiksionit të një qarku përbëjnë nivelin vendor të organizimit dhe varen administrativisht nga kryinspektori.
3. Inspektorë zone të jenë 14 veta të vendosur në këto prefektura: Tiranë, Bashkia e Tiranës, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Vlorë, Lezhë, Berat, Kukës dhe Gjirokastër. Ndarja në zona përfshin gjithë territorin e vendit sipas organizimit të bërë nga IPIE-ja.
4. Inspektorati e ka qendrën në Tiranë. Inspektorati në qendër plotësohet me mjedise nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ndërsa inspektoriatet e zonave plotësohen me mjedise pune sipas propozimeve të prefekturave, që mbulojnë zonat përkatëse.
5. Të drejtën e ushtrimit të kontrollit e kanë të gjithë inspektorët e IPIE-së, të cilët pajisen me dokument identifikimi nga sektori i sigurimit teknik të ministrisë. IPIE-ja funksionon sipas rregullores së brendshme të miratuar nga

ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

6. Për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, kryeinspektori mbledh "Komisionin e shqyrtimit të gjobave të IPIE-së". Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët propozohen nga IPIE-ja dhe miratohen nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen në rregulloren e brendshme të IPIE-së.

7. Ndaj masave të marra nga inspektorët bëhet ankimi, me shkrim, te kryeinspektori i IPIE-së, brenda 5 ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit. Vendimi i këtij të fundit duhet të jepet brenda një afati 10-ditor nga data e mbërritjes së ankesës në IPIE.

8. Në vendimin nr.75, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për numrin e punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2001", të parashikohet shtesa e numrit të punonjësve prej 20 vetësh. Struktura organizative e Inspektoratit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike është sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore" shtohet lidhja 11-27,

"Niveli i pagave të punonjësve të Inspektoratit të pajisjeve dhe instalimeve elektrike", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Efekti ekonomik i kalimit të IPIE-së në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, për periudhën qershor-dhjetor të vitit 2001, prej 10 180 517 lekësh, të përballohet nga të ardhurat që krijon Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, përjashtimisht nga vendimi nr. 424, datë 9.7.1998, i Këshillit të Ministrave, "Për të ardhurat që krijojnë institutet buxhetore".

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi nr.148, datë 9.12.1967, i Këshillit të Ministrave, "Për Inspektoratin shtetëror të sigurimit teknik për instalimet dhe pajisjet elektrike" ndryshuar me vendimin nr. 108, datë 25.3.1980 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

ILIR META

**MINISTRI I EKONOMISE
PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT**

MUSTAFA MUCI